

Këngëtarja e xhazit, Elina Duni dha koncert në Cyrih

# Elina shkëlqen me tërë paraqitjen e saj

Elina Duni me zërin dhe gjithë paraqitjen e saj, shkëlqen edhe në skenën e Cyrihut. Këtë e bën duke theksuar pa komplekse përkatësinë e saj shqiptare. Duke prezantuar një këngë kosovare ajo shfrytëzoi nga rasti të përshëndeste edhe "Republikën e re dhe të bukur të Kosovës"

Blerim Shabani

Këngëtarja e xhazit, shqiptarja me qëndrim në Zvicër, Elina Duni ka magjepsur publikun e mbledhur të enjten e kaluar në ambientin e ngrohtë të sallës Moods në Cyrih. Zëri, interpretimi, mishërimi i thellë me këngën dhe mandej e gjithë paraqitja skenike e Elina Dunit e bënin komplet përjetimin e atyre që kishin ardhur për të dëgjuar dhe parë këngëtarin tonë që kohëve të fundit ka bërë një depërtim mjaft serioz në skenat e xhazit në Zvicër dhe Gjermani. Në repertorin e saj mbizotëron kënga popullore shqiptare e të gjitha trevave, e cila i nënshtrohet një përpunimi dhe orkestrimi sipas kërkesave të xhazit. Këngët e njohura nga tradita jonë si "Baresha" (e Nexhmije Pagarushës), "Një lule", "çobankat" "Kiparisi" etj. në interpretimin e Elina Dunit zbulojnë mundësi të reja të shprehjes së këngës së vjetër shqiptare, dhe dëshmojnë se ajo ka çfarë t'u ofrojë edhe shprehjeve muzikore moderne, çfarë është dhe xhazi. Elina, përveç me këndimin e saj, me timbrin karakteristik të zërit, pushton publikun dhe mbizotëron atmosferën e koncertit edhe me paraqitjen e saj prej një artisteje që e karakterizon spontaniteti. Ajo ia del që, duke qenë gjithmonë vetvetja, pa teket dhe pa aureolën e rreme të "artisteve të mëdha", të bëhet megjithatë sovranë në skenë, të pushtojë atë të tërën dhe të tërheq për vete gjatë tërë kohës gjithë vëmendjen dhe admirimin e publikut. Por, kjo nuk ia ul vlerën edhe orkestrës së vogël që bashkë



Elina në koncertin e mbajtur në Cyrih

me solisten e përbën kuartetin që mban emrin e Elina Dunit. Aty janë: Collin Valon (piano), Bänz Oester (bas) dhe Norbert Pfammatter (timpane, bateri). Është merita e tyre që kanë trimëruar këngëtarin shqiptar-zviceranë që të marrë pikërisht këngë nga tradita e popullit të saj dhe nga Ballkani për t'u dhënë atyre një petk modern. Ata, siç na e dëshmuar pas koncertit, ishin të bindur se muzika tradicionale shqiptare ka një brumë të klasit të parë për tu përpunuar në një muzikë xhazi. Këtë ia mundëson pasuria tingullore dhe

## Nga këngët për fëmijë deri te "Konstandini dhe Doruntina"

Elina Duni është fëmijë e dy artistëve. Babai i saj Spiro Duni, është regjisor dhe aktor ndërsa nëna Besa Myftiu, shkrimtare dhe skenariste. Që në moshën shumë të hershme ajo ka provuar veten në paraqitje skenike me këngë për fëmijë. Ishte rreth dhjetë vjeçe kur, së bashku me nënën e saj kalon për të jetuar në Zvicër, në Gjenevë. Këtu ajo ka ndjekur shkollimin e rregullt ndërsa akademinë muzikore, drejtimi i xhazit e ka mbaruar në Bernë, qytet ku ajo jeton dhe ka filluar të ndërtojë një karrierë të suksesshme artistike. Më 30 gusht Elina ka mbratur temën e diplomës, duke bërë kompozimin në xhaz të bazuar në legjendën "Konstandini dhe Doruntina". Këtë vepër ajo e ka interpretuar në një skenë të Bernës së bashku me një oktet, dhe është prituri mjaft mirë nga publiku.

ndjenja e thellë, dhimbja e madhe që ndërthet ajo në vete.

Përveç këngëve nga burimi i traditës shqiptare, Elina Duni në këtë koncert interpretoi edhe disa këngë të autorit francez Serge Gainsbourg, dy këngë tradicionale greke dhe një bullgare, duke arritur që në të gjitha përthyerjet që i bëjnë këto këngë të ndryshojnë mjaft nga njëra-tjetra, të ruajë identitetin e të kënduarit të saj, të Elinës.

Ajo që të befason për të mirë në paraqitjen në skenë të Dunit është edhe theksimi pa komplekse i përk-



Së bashku me kuartetin e saj

atësisë shqiptare nga ana e saj. Përveç tjerash ajo këtë e bëri edhe përmes përshëndetjes në gjuhën shqipe të publikut, në mesin e të cilit, për hir të të vërtetës duhet thënë se nuk ishin më shumë se dhjetë shqiptarë! Mandej, duke prezantuar këngët dhe duke ua parafrazuar tekstin, këngëtarja e xhazit shfrytëzoi rastin që të jepte edhe një mesazh diskret politik! Tek prezantoi këngën "Baresha", ajo, duke iu drejtuar publikut në gjuhën gjermane, vuri theksin në prejardhjen e kësaj kënge nga "Kosova, kjo Republikë e re dhe e

bukur që ka lindur sivjet në Evropë". Me këtë urim, ajo ka ngritur lartë emocionet e të pranishmëve shqiptarë por ka nxitur edhe miratimin me duartrokitje, nga i gjithë publiku i pranishëm.

Koncerti i mbajtur në Cyrih ishte pjesë e një turneu që Elina dhe kuarteti i saj e kanë filluar nga fundi i muajit gusht, nëpër Zvicër dhe Gjermani. Pas një ndërprerje të shkurtër, turneu do të vazhdojë nëpër qytete të ndryshme gjermane, vend ky në të cilin Elina Duni ka bërë tashmë një emër të nderuar. ■

Manifestim kulturor i Shoqatës Kulturore Shqiptare-Gjermane në Kiel të Gjermanisë

## Takime kulturore mes dy popujve evropianë

Në kuadër të javëve interkulturore që organizon Forumi për të Huajt i qytetit të Kielit, ku për tri javë të tëra paraqiten me kulturat e tyre shoqatat kulturore nga shumë vende të huaja, gjatë katër viteve të fundit është prezantuar rregullisht edhe Shoqata Kulturore Shqiptaro-Gjermane "Jetullah Islami" nga Kiel. Kësaj radhe kjo shoqatë bën një organizim të përbashkët kulturor me Kryqin e Kuq Gjerman, rrethi i Kielit, me moton "Ndërlidhja e kulturave shqiptarogjermane".

Ky tubim i prezantimit të kulturës shqiptare do të mbahet të shtunën, më datën 27.09.2008 dhe fillon në orën 15. Në këtë manifestim të takimit në mes të kulturës shqiptare dhe asaj gjermane, shoqata do të paraqitet me grupin e fëmijëve

"Shqiponjat", me grupin muzikor të të rriturve "Kosova". Po ashtu do të jepet në gjuhën gjermane pjesa teatrale "Peripeçitë e mërgimtarit shqiptar". Gjithashtu me fjalimet e tyre do të prezantohen përfaqësuesit e Kryqit të Kuq Gjerman dhe përfaqësuesit e qytetit të Kielit.

Prandaj ftohen të gjithë shqiptarët, pa dallime krahine, feje, apo

ideje që të marrin pjesë në këtë manifestim të prezantimit të kulturës shqiptare.

Manifestimi mbahet në sallën e Kryqit të Kuq Gjerman, në rrugën Klaus-Groth-Platz 1, të shtunën 27.09.2008. dhe fillon në ora 15.

Komisioni për informim i Shoqatës Kulturore Shqiptarogjermane "Jetullah Islami" me seli në Kiel, Gjermani. ■

Më 28 shtator në Wohlen, Zvicër

## Mbahet Kuvendi Zgjedhor i SHH "Hasi"

Të nderuar bashkatdhetarë. Shoqata Humanitare "Hasi" mban Kuvendin Zgjedhor, ku do të zgjidhet kryesia e re e kësaj shoqate për dy vjetet e ardhshme, prandaj ju ftojme që të merrni pjesë në të.

Kuvendi mbahet të dielën, më 28.09.08, duke filluar nga ora 13:00 në klubin Flamuri

Adresa: Geverbering 10, 5610 Wohlen. ■

Në Policinë kantonale të Cyrihut

## Një qendër profesionale ndërmjetësuese me të huajt

Nga fillimi i vitit 2008 Policia Kantonale e Cyrihut është duke udhëhequr një qendër profesionale ndërmjetësimi të mbiquajtur "Brückenbauer" (ndërtues urash). Ky shërbim përbëhet nga 12 pjesëtarë të policisë që në këtë shërbim ndihmës, shërbejnë si persona ndërlidhës "ndërtues urash" në mes të policisë dhe qytetarëve me prejardhje të huaj.

Në takimet e organizuara të

këtyre ndërmjetësuesve me personat me prejardhje të huaj, me shoqatat e të huajve ose me institucione nga lëmi i migracionit, synohet realizimi i dy qëllimeve: së pari, personave me prejardhje të huaj do t'u prezantohen detyrat e policisë së këtushme dhe së dyti, pjesëtarët e policisë kantonale do të përfitojnë më shumë njohuri lidhur me kulturat dhe zakonet e huaja. Në këtë mënyrë do të ndër-

tohet një mirëkuptim më i mirë i ndërsjellë.

Me këtë veprim Policia e Kantonit të Cyrihut po përpiqet të japë, ashtu siç e kërkon Ligji i ri Federal për të Huajt, një kontribut për ndërtimin e integritimit.

Shërbimi profesional mund të kontaktohet përmes numrit kryesor të Policisë së kantonit të Cyrihut 044 247 22 11 ose përmes e-mailit: brueckenbauer@kapo.zh.ch ■

Më 23 shtator në Hamburg

## Shfaqje me karakter edukimi politik

"Shoqata për Arsim, Kulturë dhe Mirëqenie të Popujve në Hamburg dhe Rrethinë" ka përgatitur një shfaqje me karakter të arsimit politik, tema e së cilës është "Diskriminimi në vend të punës dhe statusi i qëndrimit". Shfaqja do të mbahet

të martën, më 23.09.2008, prej orës 12:00 - 16:30, në Bürgerhaus Wilhelmsburg Mengestr. 20, 21107 Hamburg

Të gjithë bashkatdhetarët shqiptarë mund të marrin pjesë në këtë takim të rëndësishëm, ku bëhet fjalë për të drejtat e punëtorëve emigrantë. Referate do të mbahen nga organizata "basis und woge", organizatë ku mund të këshillohen punëtorët emigrantë që ndjehen të diskriminuar në vend të punës, avokatët për të drejtat e punës, të qëndrimit dhe avokatët me pikë kyçe antidiskriminimi. Në fund do të ketë edhe diskutim në podium, në të cilin do të marrin pjesë përfaqësues nga zyra për të huajt (Ausländerbehörde), qendra për punësim (Agentur für Arbeit), një organizatë për të drejtat e punëtorëve në Gjermani (DGB) dhe një avokat për të drejta qëndrimi.

Të gjithë ata që janë të prekur nga tema në fjalë, apo ju intereson tema në përgjithësi mund të marrin pjesë në këtë takim. Hyrja është 5 □.

Afërdita Halimi

Sonte në Cyrih

## Mbahet mbrëmja e tretë informative me prindër shqiptarë

Në organizim të Këshillimores për rini të qytetit të Cyrihut, qendrës rinore OJA, (Puna e Hapur me Rini), dhe Shërbimit shkollor psikologjik sonte (e martë), në Jugendberatung der Stadt, mbahet mbrëmja e tretë nga seria e mbrëmjeve informative me prindër shqiptarë. Derisa në mbrëmjen e dytë u shtjelluan temat mbi shkollën dhe zgjedhjen e profesionit, në mbrëmjen e tretë që mbahet të martën me 23 shtator 2008 (nga ora 19.15-21.15 minuta do të shtjellohen këto tema: Koha e lirë dhe kolegët, pastaj tema që ka të bëjë me atë se: "Cilat janë ndikimet dhe efektet e mundshme tek fëmijët e të rinjtë si dhe tema për: Varshmëritë, p.sh. tek mediet elektronike dhe konsumi i substancave (të njohura dhe të panjohura) që shkaktojnë varshmërinë. Organizatori lut pjesëmarrësit, gjegjësisht prindërit shqiptarë që të jenë të përpiktë sa i përket ardhjes me kohë. Parimisht parashihet që të ketë kohë dhe vend për dy pjesët: informim por edhe diskutim

Ky takim mbahet në vendin ku janë mbajtur edhe dy të mëparshmit, në Röntgenstrasse 44, 8005 Cyrih. ■